

BULETIN I VENDIMEVE GJYQËSORE

VOLUMI 14

(KORRIK-DHJETOR 2023)

PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS ADMINISTRATIVE

1.Vendim nr.1072, datë 14.12.2023	1
2.Vendim nr.286, datë 12.06.2023	6
3.Vendim nr. 537(86-2023-784), datë 17.07.2023.....	8
4.Vendim nr. 498 (86-2023-752), datë 13.07.2023.....	11
5. Vendim nr. 00-2023-1876 (173), datë 11.05.2023	14
6. Vendim nr. 425, datë 23.05.2023,	16
7. Vendim nr. 00-2023-4189, datë 25.09.2023	18

1. Vendim nr. 1072, datë 14.12.2023, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë

Paditës : Shoqëria "A" sh.p.k, me NIPT K _____

Të paditur: Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë, Drejtoria Rajonale Tatimore Berat

Objekti: Shfuqizim dhe konstatim të pavlefshmërisë absolute të akteve administrative...

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Shoqëria "A" Shpk, me NIPT K _____, është regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat me datë 21.11.2003, me objekt veprimtarie: *"Import-eksport tregti me shumicë e pakicë materiale ndërtimi, vegla e makineri paisje që përdoren në fushën e ndërtimit. Shërbime në fushën e ndërtimit, montimit, projektimit dhe zbatimit. Ndërtimi i objekteve publike e private, rikonstruksioni e riparimi i tyre etj"*

Me anë të Njoftim Vlerësimit nr. _____ prot., datë 28/07/2016 dhe nr. _____ prot., datë 28/07/2016 dërguar nga DRT Berat, pala paditëse është njohur për detyrimet e nxjerra nga Raporti i Kontrollit të kryer nga ana e drejtorisë.

Pala paditëse e ka ankimuar aktin administrativ për detyrimet tatimore Njoftim Vlerësimin nr. _____ prot., dhe nr. _____ prot., datë 28/07/2016, në Drejtorinë e Apelit Tatimor Tiranë, e cila me vendimin nr. _____ datë 18.11.2016 ka vendosur: *Lënien në fuqi të aktit administrativ, Njoftim Vlerësimi nr. _____ prot. dhe nr. _____ prot., datë 28/07/2016, si dhe shfuqizimin për gjobën në vlerën _____ lekë.*

Në këto rrethana të faktit, pala paditëse i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke thirrur në gjykim si palë të paditur Drejtorinë e Apelit Tatimor Tiranë dhe Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat, me padinë me objektin e sipërcituar.

Me vendimin Nr. 334, datë 03.03.2017, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka vendosur: *rrëzimin e kërkesëpadisë.*

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala paditëse shoqëria "A" sh.p.k, në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, ku ka kërkuar ndryshimin e vendimit dhe pranimin e padisë.

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin Nr.1072, datë 14.12.2023, pas shqyrtimit të çështjes vendosi: *Lënien në fuqi të vendimit nr. 334, datë 03.03 .2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.*

Vlerësimi i Gjykatës:

Vendimi nr. 334, datë 03.03.2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë është marrë në perputhje me ligjin material dhe atë procedural, për shkaqet e mëposhtme:

Përsa i përket procedurës së nxjerrjes së akteve administrative objekt gjykimi, ka rezultuar se me shkresën nr. _____ Prot., datë 23.06.2016, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat, Drejtoria e Kontrollit Tatimor ka njoftuar shoqërinë "A" sh.p.k., për kryerje kontrolli. Nga inspektorët e Drejtorisë Rajonale Tatimore Berat është ushtruar kontroll për periudhën 2013-2016, ku në përfundim të tij është nxjerrë raport-kontrolli i datës 27.07.2016.

Me shkresën nr. _____ Prot. datë 15.07.2016, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat, Drejtoria e Kontrollit Tatimor i ka dërguar shoqërisë "A" sh.p.k., projekt raport kontrollin. Nga ana e inspektorëve me shkresën nr. _____ Prot., datë 27.07.2016, është kërkuar hapja e çështjes për të hedhur detyrimin në sistem. Me shkresën nr. _____ Prot., datë 28.07.2016, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Berat, Drejtoria e Kontrollit Tatimor i ka dërguar shoqërisë "A" sh.p.k., raport kontrollin tatimor. Me shkresën nr. _____, datë 28.07.2016 dhe me nr. _____, datë 28.07.201 "Njoftim vlerësimi për detyrimet", Drejtoria Rajonale Tatimore Berat ka njoftuar shoqërinë për të paguar detyrimet e papaguara duke e njoftuar dhe për mundësinë e kundërshtimit të detyrimeve pranë Drejtorisë së Apelimit Tatimor.

Pra nga tërësia e kesaj veprimtarie administrative, gjykata vlerëson se pala e paditur ka respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor, të cilat nuk janë të kufizuara vetëm në procesin gjyqësor, por edhe në atë me karakter administrativ (vendimi nr.7 dt.27.02.2012 i Gjykatës Kushtetuese).

Në pikën iii) të gërmës a) të nenit 108 të K.Pr.Administrative, parashikohet një tjetër rast i pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ. Kjo pavlefshmeri ka të bëjë me mosrespektimin e formës së nxjerrjes së aktit administrativ. Respektimi i formës perben një kriter për vlefshmërinë e aktit. Lidhur me formën, neni 98 i K.Pr.Administrative parashikon se: *Perveç rasteve kur parashikohet ndryshe nga ligji, akti administrativ ka formë të shkruar në letër ose elektronike, verbale, ose çdo formë tjetër të përshtatshme.*

Në këndvështrim të kësaj dispozite, aktet administrative objekt kontestimi, janë në formë të shkruar, çka do të thotë se forma e nxjerrjes së akteve administrative është respektuar. Po kështu, aktet administrative objekt gjykimi nuk janë nxjerrë nëpërmjet mashtrimit, kanosjes, mitmarrjes, konfliktit të interesit, falsifikimit apo një veprimi tjetër që përbën vepër penale, apo që ekzekutimi i aktit, objekt gjykimi, mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal, dhe si të tillë nuk mund të konsiderohen absolutisht të pavlefshëm, sipas gërmës b) dhe c) të nenit 108 të K.Pr.Administrative. Konkretisht gjatë këtij procesi gjyqësor nuk është provuar që ekzekutimi i aktit administrativ, objekt gjykimi, mund të shkaktojë një veprim të dënueshëm, sipas legjislacionit penal (gërma c) e nenit 108 të K.Pr.Administrative). Pra, në analizë të fakteve dhe kuadrit ligjor të sipërcituar, me të drejtë Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka konkluduar se aktet administrative, objekt gjykimi, nuk janë akte administrative absolutisht të pavlefshëm, siç ka pretenduar pala paditëse.

Vendimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1072 datë 14.12.2023 vendosi:

- *Lënie në fuqi të vendimit nr. 334, datë 03.03 .2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.*

2. Vendim nr.286, datë 12.06.2023, i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës

Paditës: Shoqëria “M” shpk, NIPT L_____

Të paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Durrës
Drejtoria e Apelimit Tatimor Tiranë

Objekti: Shfuqizim të Njoftim Vlerësimit Nr.____ Prot., Dt.21.09.2020, të DRT Durrës dhe shfuqizim të Vendimit Nr.____ Prot., Dt.05.01.2021, të DAT Tiranë.

Shuma e detyrimit tatimor: _____ lekë

Baza Ligjore: Ligj nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; ligj nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar etj

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Pala paditëse ushtron aktivitet si subjekt i të drejtës tregtare shqiptare, me formë organizimi “shpk”, me NIPT L_____. Nga ana e inspektorëve të Drejtorisë së Hetimit Tatimor pranë DPT, në datë 11.08.2020, është ushtruar kontroll, në ambientet e ushtrimit të aktivitetit të paditësit, duke mbajtur Akt Konstatimin Nr.____, Dt.11.08.2020. Në përfundim të kontrollit të ushtruar nga ana e Inspektorëve të Drejtorisë së Hetimit Tatimor, është penalizuar tatimpaguesi me gjobë në masën _____ lekë, sipas Procesverbalit të Gjobës Nr.____, Dt.11.08.2020, për moslëshim të kuponit tatimor. DRT Durrës, bazuar në këto akte të sipërcituara ka lëshuar Njoftim Vlerësimin për detyrimet Nr.____ Prot., Dt.21.09.2020.

Tatimpaguesi pasi është njohur me Aktin Administrativ, e ka ankimuar atë në Drejtorinë e Apelimit Tatimor, organ ky i cili nëpërmjet vendimit Nr.____ Prot, Dt.05.01.2021, ka vendosur lënien në fuqi të aktit administrativ, Njoftim Vlerësimit Nr.____ Prot., Dt.21.09.2020.

Nga ana e palës paditëse, është paraqitur Kërkesëpadi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, me objekt shfuqizimin e akteve administrative.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, gjatë shqyrtimit të çështjes, analizimit të akteve të paraqitura nga palët dhe argumentimit të pretendimeve të secilës prej tyre, ka konkluduar se administrata tatimore në akt konstatimin e mbajtur gjatë kontrollit në ambientin e ushtrimit të aktivitetit të paditësit, ka konstatuar se “ ... në momentin e kontrollit subjekti nuk ka lëshuar kupon tatimor për një kafë me vlerën 70 lekë..”, por pala paditëse ka paraqitur të gjithë kuponët tatimor të lëshuar gjatë ditës 11.08.2020 nga kasa fiskale, si provë e lëvizjes së mallrave gjatë ditës së inspektimit.

Nga hetimi i kryer nga Gjykata për zgjidhjen e kësaj çështjeje, ka rezultuar se Inspektorët e Drejtorisë

së Hetimit Tatimor, kanë penalizuar tatimpaguesin me pretendimin se nuk ka lëshuar kupon tatimor, por nuk kanë evidentuar momentin në të cilin është konstatuar shkelja, por përcaktojnë harkun kohor gjatë të cilit është ushtruar kontroll nga ora 14:25 - 15:15. Evidentimi i kohës së kryerjes së shkeljes bëhet i nevojshëm për të provuar përgjegjësinë administrative të subjektit, duke patur parasysh provën e sjellë nga pala paditëse në lidhje me kuponët tatimor të lëshuar gjatë datës 11.08.2020, ku evidentohet lëvizja e mallrave dhe fashën orare të kontrollit, nëpërmjet të cilëve vërtetohet lëshimi i kuponëve tatimor në mënyrë të rregullt, duke u evidentuar dhe rasti i shitjes së një kafe me vlerë 70 lekë.

Në këto kushte, Gjykata vlerëson se inspektorët duhet të hetonin në lidhje me pretendimet që pala paditëse kishte sa i takon mosekzistencës së faktit, verifikimit të kuponëve të printuar nga kasa fiskale, referuar momentit të kontrollit, nga ku rezulton se pala paditëse nuk ka patur qëllim shmangien nga detyrimet tatimore.

Sa më sipër, sipas Gjykatës, organi publik nuk ka arritur të vërtetojë në mënyrë të padyshimtë përgjegjësinë administrative të subjektit tatimor dhe bazuar në këtë arsyetim, Gjykata ka vendosur:

Vendimi i Gjykatës:

- Pranimin e padisë...

3. Vendim nr.537(86-2023-784), datë 17.07.2023, i Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë

Paditës: Subjekti “M-F-X”, me Nipt L_____

Të paditur: Drejtoria Rajonale Tatimore Sarandë
Drejtoria e Apelit Tatimor Tiranë

Objekti: - Deklarimin e pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimit për detyrimet nr.____ prot datë 21.06.2016, për pagesën e TVSH-së në shumën _____ lekë;

- Deklarimin e pavlefshmërisë të vendimit nr.____ prot, datë 28.09.2016, të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë.

Baza Ligjore : Ligj nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligj nr. 8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; udhëzimi nr.19, datë 03.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”; ligj nr.44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” etj

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Tatimpaguesi “M-F-X”, me Nipt L_____, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjyrokastër me kërkesëpadinë me objekt: - deklarimin e pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimit për detyrimet nr.____ prot, datë 21.06.2016, për pagesën e TVSH-së në shumën ____ lekë; - deklarimin e pavlefshmërisë të vendimit nr.____ prot, datë 28.09.2016, të Drejtorisë së Apelit Tatimor Tiranë.

Akti administrativ Njoftim Vlerësimi për detyrimet tatimore nr.____ prot, datë 21.06.2016, është nxjerrë nga DRT Sarandë bazuar në Aktin e Rivlerësimit “Për Formularin e Deklarimit dhe Pagesës së TVSH-së” nr.____ prot, datë 23.11.2015, i mbajtur nga inspektori i Drejtorisë së Vlerësimit, Përpunimit dhe Mbledhjes së të Ardhurave në DRT Sarandë. Ky akt rivlerësimi ka nxjerrë detyrimet në zërin TVSH, për tatimpaguesin “M-F-X” shoqëri e bashkëpunimit bujqësor, pasi ky tatimpagues ka vepruar në kundërshtim me përcaktimet e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.19, datë 03.11.2014, “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”.

Konkretisht ky tatimpagues, i cili është aplikues i skemës së kompensimit të fermerëve, rezulton se ka kryer blerje nga individë të peregjistruar si fermerë pranë DRT Sarandë, kjo në kundërshtim me kërkesat e pikës 4 të UMF nr.19, datë 03.11.2014, ku përcaktohet qartë se:

Fermerët që janë objekt i skemës së kompensimit, duhet të pajisen me një numër identifikimi (NIPT), lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore ku ushtron aktivitetin fermeri për të përfituar nga kjo skemë kompensimi, pa ju nënshtruar detyrimit për deklarim.

Për këtë procedurë të kryer në kundërshtim me dispozitën ligjore, nga ana e DRT Sarandë është kryer rivlerësim i detyrimeve për tatimpaguesin “M-F-X” duke i nxjerrë detyrimet në zërin TVSH, për

periudhën nëntor-dhjetor 2014 në shumën në total ____ lekë.

Tatimpaguesi “M-F-X”, ka ankimuar në DAT Tiranë aktin administrativ të nxjerrë nga DRT Sarandë e konkretisht Njoftim Vlerësimin nr.____ prot, datë 21.06.2016.

DAT Tiranë me vendimin e saj nr.____ prot, datë 28.09.2016, ka vendosur refuzimin e ankimit, pasi nuk janë përmbushur kërkesat dhe procedurat e përcaktuara në nenin 107 të Ligjit nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, lidhur me përmbushjen e detyrimit për pagesë të shumës së caktuar, para skadimit të afatit të ankimit.

Më pas ky tatimpagues ndoqi rrugën e ankimit gjyqësor, ndaj këtyre akteve administrative, duke iu drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër me kërkesëpadinë me objekt:

- deklarimin e pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimin për detyrimet nr.____ prot datë 21.06.2016, për pagesën e TVSH-së në shumën ____ lekë;
- deklarimin e pavlefshmërisë të vendimit nr.____ prot, datë 28.09.2016, të Drejtorisë së Apelitit Tatimor Tiranë.

Kjo çështje pasi u gjykua nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Gjirokastër, me vendimin e saj nr.72 datë 14.02.2017, ka vendosur: **Rrëzimin e kërkesëpadisë.**

Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim tatimpaguesi “M-F-X” dhe Gjykata Administrative e Apelit Tiranë pasi mori në shqyrtim në dhomë këshillimi këtë çështje administrative, me vendimin e saj nr.537(86-2023-784), datë 17.07.2023 ka vlerësuar se:

Vlerësimi i Gjykatës:

Fillimisht Gjykata vlerëson se: Përkatesisht në nenin 115 të K.Pr.Administrative, pavlefshmëria e akteve administrative, në kuptim të këtij Kodi, paraqitet në format e mëposhtme: a) akte administrative absolutisht të pavlefshëm (akte të nxjerra në kundërshtim flagrant me ligjin); b) akte administrative relativisht të pavlefshëm (akte të nxjerra në kundërshtim me ligjin).

Në përmbajtje të këtij neni kriteri dallues ndërmjet këtyre dy pavlefshmërive lidhet me shkallën e shkeljes së ligjit nga organi publik respektiv në nxjerrjen e aktit. Nëse vullneti i shprehur nga organi publik është në shkelje të ligjit atëherë bëhet fjalë për pavlefshmëri relative (s’është objekt gjykimi) dhe nëse ky vullnet i shprehur është në kundërshtim flagrant me ligjin atëherë jemi para pavlefshmërisë absolute të tij(objekt gjykimi).

Më tej në rendin vazhdues të dispozitave ndodhet neni 16 i K.Pr.Administrative me këtë përmbajtje: Aktet administrative do të quhen absolutisht të pavlefshëm, në kuptim të këtij Kodi, në rastet e mëposhtme: a) kur akti është nxjerrë nga një organ i paidentifikuar; b) kur akti është nxjerrë nga një organ administrativ në kapërcim të kompetencave të tij ligjore; c)kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji”.

Në këtë nen tashmë është elaboruar koncepti i shkeljes flagrante të ligjit. Pra kur do të jemi para shkeljes flagrante të ligjit dhe për rrjedhojë do të jemi para pavlefshmërisë absolute të aktit.

Është e rëndësishme të theksohet fakti se kemi pavlefshmëri absolute të aktit vetëm në këto tre raste dhe në asnjë rast tjetër të shkeljes së ligjit.

Si rrjedhojë në çastin që pala paditëse kërkon të mbrohet me padinë e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ që atakon në gjykatë ka detyrimin absolut të identifikojë pretendimin e saj në të paktën një nga këto raste.

Në interpretim të këtij kuadri ligjor është shumë e rëndësishme të theksohet fakti se pavlefshmëria absolute lidhet në mënyrë organike me aktin administrativ që atakohet dhe distancohet nga rrethanat e faktit dhe vlerësimi i situatës së bërë nga organi publik mbi këto rrethana faktike.

Gjykata vlerëson në rastin konkret se pala e paditur DRT Sarandë, në rastin e marrjes së këtyre vendimeve është brenda kompetencave të saj dhe nuk ka tejkalim kompetence lëndore/funksionale apo tokësore nga ana e saj.

Me tej kjo gjykatë vlerëson se në rastin konkret nuk vërehet asnjë handikap flagrant me formën apo elementë të tjerë të detyrueshëm të aktit administrativ që kundërshton pala paditëse.

Pala paditëse krahas pretendimit për pavlefshmëri absolute në formë i shtrin pretendimet e saj dhe për pavlefshmëri relative të akteve objekt shqyrtimi.

Ritheksohet nga gjykata se në çdo rast pavlefshmëria absolute lidhet me aktin dhe elemente të procedurës dhe formës së nxjerrjes së tij dhe nuk lidhet me vlerësimin e gjendjes së faktit.

Sa më lart gjykata konkludon se akti i nxjerrë nga pala e paditur nuk është absolutisht i pavlefshëm.

Gjykata në përfundim të kësaj analize ligjore të fakteve objekt verifikimi dhe duke vlerësuar kërkimet e palës paditëse në padi dhe në ankim, prapësimet e palës së paditur, raportin shkak ligjor-bazë juridike objekt kërkimesh gjendje fakti, pasi çmoi provat e marra në gjykim konkludon se drejtë ka vendosur Gjykata Administrative e Shkalës së Parë Gjirokastrë e cila me vendimin e saj nr.72/2017 ka vendosur rrëzimin e padisë. Si rrjedhojë vendimi nr.72/2017 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë është marrë në përputhje me ligjin dhe provat dhe lihet në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë.

Vendimi i Gjykatës:

- *Lënien në fuqi të vendimit nr.72 datë 14.02.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastrë.*

4. Vendim nr.498 (86-2023-752), datë 13.07.2023, i Gjykatës Administrative të Apelit

Paditës: Shoqëria “G” sh.p.k.

Të paditur: Drejtoria e Apelimit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë

Objekti: Shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore me nr. _____ prot., datë 19.01.2016, lëshuar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, Drejtoria e Verifikimit në Terren ndaj tatimpaguesit “G” sh.p.k, si dhe aktit administrativ - vendim i Drejtorisë së Apelimit Tatimor Tiranë me nr. _____ prot., datë 13.05.2016, për lënien në fuqi të aktit administrativ njoftim vlerësimi nr. _____ prot., datë 19.01.2016 të nxjerrë nga DRT Tiranë.

Shuma e detyrimit tatimor: _____ lekë

Baza Ligjore : Kodi i Procedurës Civile, ligji nr.49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; ligji nr.9920/2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr.8510/1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore” etj

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Shoqëria “G” sh.p.k me numër NIPT-i K _____ është regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë për aktivitetin import-eksport dhe shitblerje prodhime druri dhe nënproduktet e tyre. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ushtron kontrole periodike pranë subjekteve tregtare të regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë si dhe bashkëpunon duke shkëmbyer informacion zyrtar me shumë institucione, bashkëpunim i cili i shërben mbarëvajtjes së veprimtarisë të këtyre institucioneve. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, sipas urdhrorit të punës nr. _____, datë 08.01.2016, ka ushtruar kontroll në adresën e deklaruar nga shoqëria në QKR. Grupi i kontrollit ka tërhequr nga tatimpaguesi inventarin kontabël të datës 31.12.2015 me numër artikujsh 11 dhe vlerë _____ lekë. Gjithashtu është kryer tërheqja e faturës së fundit në blerje dhe shitje, si dhe kryerja e inventarit fizik të inventarit. Nga inventarizimi fizik i gjendjes së inventarit ka rezultuar se magazinat e mallit në adresën rruga “Don Bosko” nr.14 dhe 14/1 janë të boshatisura. Me kryerjen e bilancit material për periudhën nga 01.01.2016 deri më 10.01.2016 ka rezultuar diferenca material negative të cilat janë konsideruar nga kontrolli shitje malli pa faturë. Nga vlerësimi me çmimet e shitjes të paraqitura nga administratori i shoqërisë ka rezultuar një diferencë prej _____ lekë. Shoqërisë në muajin dhjetor 2015 i rriten të ardhurat në vlerën _____ lekë dhe mbështetur në nenin 124 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, shoqërisë i lind një detyrim për TVSH në vlerën _____ lekë, si dhe një gjobë 100% e detyrimit ose _____ lekë. Gjithashtu po në zbatim të nenit 124 tatimpaguesi dënohet me gjobë në masën 15% për tatim fitimin e munguar nga mosdeklarimi i faturës tatimore ose vlera _____ lekë.

Duke marrë shkak nga ky njoftim zyrtar, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ka nxjerrë aktin njoftim

vlerësimi tatimor nr. _____, datë 19.01.2016 nëpërmjet të cilit paditësi është penalizuar me gjobë në masën _____ lekë.

Vlerësimi i Gjykatës:

Gjykata Administrative e Apelit e vlerëson të gabuar konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, në lidhje me përfundimin se pala paditëse para se të ushtrohet kontrolli ka marrë vendim për të ndryshuar adresën e vendit të ushtrimit të aktivitetit, vendim të cilin e ka regjistruar gjithashtu në QKR para kontrollit, për pasojë konstatimi i palës së paditur sipas të cilës paditësi nuk ka gjendje fizike mallin e deklaruar është i gabuar.

Referuar akteve të depozituara në dosjen gjyqësore ka rezultuar e provuar se, ortakët e shoqërisë “G” sh.p.k kanë rënë dakord në asamblenë e datës 29.12.2014, veç të tjerave dhe për ndryshimin e adresës së ushtrimit të aktivitetit. Për sa më sipër, vendimi nr.____, datë 29.12.2014 i ortakëve të shoqërisë “G” sh.p.k për ndryshimin e adresës së ushtrimit të veprimtarisë është aplikuar nga përfaqësuesi i subjektit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit më datë 13.01.2016, aplikim i cili është publikuar brenda afatit një ditë në përmbushje të nenit 61 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, i ndryshuar dhe rezultoi i pasqyruar edhe në ekstraktin historik të regjistrimit tregtar të shoqërisë.

Ndërkohë referuar praktikës së mbajtur gjatë ushtrimit të kontrollit pranë këtij subjekti, rezultoi e provuar se pala paditëse shoqëria “G” sh.p.k ka qenë subjekt i një kontrolli të ushtruar nga inspektorët e palës së paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë më datë 11.01.2016 bazuar në urdhrin e punës nr. _____ prot., datë 08.01.2016, nga ku kanë rezultuar detyrime tatimore për palën paditëse.

Gjykata Administrative e Apelit konstaton se, kontrolli është kryer në ambientet e shoqërisë “G” sh.p.k të deklaruara pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit sipas ekstraktit historik të regjistrimit tregtar në momentin e ushtrimit të kontrollit, pra në adresën rruga “Don Bosko” nr.14 dhe nr.14/1 në prezencë të administratorit të shoqërisë z. A.M, i cili në deklaratën e nënshkruar rregullisht prej tij ka deklaruar se nuk ka gjendje mallrash në adresa të tjera, ku vlen të theksohet që as nuk i është bërë me dije grupit të kontrollit në lidhje me vendimin nr.____, datë 29.12.2015 të asamblesë së ortakëve të shoqërisë “G” sh.p.k.

Për pasojë konstatimi i palës së paditur sipas të cilës pala paditëse nuk rezultoi të kishte gjendje fizike mallin e deklaruar është i drejtë, për sa kohë rezultoi e provuar që pala paditëse këtë mall nuk e kishte gjendje fizike në magazinë.

Në këto kushte vlerësimi nga administrata tatimore është bërë duke u bazuar përkatësisht në nenin 68, pika 4 dhe 5 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Administrata tatimore ka të drejtë të kontrollojë saktësinë e përcaktimit të detyrimeve tatimore, ku nëpërmjet kontrolleve mund të kryhet verifikimi i saktësisë së deklarimeve tatimore për tatimin mbi fitimin, për TVSH-në dhe për të gjitha llojet e tjera të detyrimeve tatimore, por në kushtet e mungesës së mallrave gjatë kryerjes së bilancit material ose inventarizimit fizik të tyre, kjo do të konsiderohet shitje pa faturë tatimore dhe pas vlerësimit tatimor, administrata tatimore në aplikim të nenit 124 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 vendos dënimin administrativ me gjobë në masën 100% të detyrimit tatimor të padeklaruar si rezultat i moslëshimit të faturës.

Për sa më sipër, Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, akti administrativ njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr. ____ prot., datë 19.01.2016 i lëshuar nga pala e paditur Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. ____ prot., datë 13.05.2016 të Drejtorisë së Apelimit Tatimor, janë akte administrative të nxjerra në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi dhe për pasojë nuk mund të çënohen në rrugë gjyqësore.

Vendimi i Gjykatës:

-Ndryshimin e vendimit nr. 5559 (80-2016-5591), datë 23.11.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe rrëzimin e padisë.

5. Vendim nr. 00-2023-1876 (173), datë 11.05.2023, i Gjykatës së Lartë

Paditës: A.H

Të paditur: Drejtoria e Apelit Tatimor, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë

Objekti: Anulim i aktit administrativ, njoftim vlerësim për detyrimet tatimore “Gjobë” nr. ____ prot., datë 20.01.2014, të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë dhe vendimit nr. ____ prot., datë 08.05.2014, të Drejtorisë së Apelit Tatimor.

Shuma e detyrimit tatimor: _____ lekë

Baza Ligjore : Kodi i Procedurës Civile, Kodi i Procedurave Administrative, ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar etj

Përmbledhje e rrethanave të faktit:

Tatimpaguesi A.H me numër NIPT-i L_____ është regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë për aktivitetin punime druri. Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ushtron kontrolle periodike pranë subjekteve tregtare të regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Tiranë si dhe bashkëpunon duke shkëmbyer informacion zyrtar me shumë institucione, bashkëpunim i cili i shërben mbarëvajtjes së veprimtarisë të këtyre institucioneve.

Drejtorja Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. _____, datë 06.12.2013 të Drejtorisë Rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Punës, është njoftuar zyrtarisht se pranë paditësit është mbajtur një procesverbal në të cilin është evidentuar se në ambientet ku ushtrohej aktivitet janë gjetur 7 punonjës të cilët, pas verifikimeve të kryera në sistemin informatik, kanë rezultuar të padeklaruar në organet tatimore për periudhën dhjetor 2012.

Duke marrë shkak nga ky njoftim zyrtar, Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ka nxjerrë aktin njoftim vlerësimi tatimor nr. _____, datë 20.01.2014 nëpërmjet të cilit paditësi është penalizuar me gjobë në masën _____ lekë për mosdeklarim të 7 punonjësve në organin tatimor, gjobë e cila është e parashikuar në nenin 119 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008.

Në kushtet kur tatimpaguesi nuk ka përmbushur detyrimin për deklarim në organin tatimor të punëmarrësve, 24 orë përpara fillimit të punës, gjykojmë që gjoba duhet të mbetet në fuqi.

Vlerësimi i Gjykatës

Kolegji e gjen të bazuar vlerësimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, në lidhje me rrëzimin e padisë, për shkak se paditësi ka shkëlur dispozitat në fuqi në kohën e lindjes së mosmarrëveshjes, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, konkretisht nenin 119. Kjo dispozitë parashikon se: “1. Nëse nga verifikimi dhe kontrolli në vendndodhjen e biznesit rezulton se tatimpaguesi nuk ka deklaruar në organin tatimor

çdo të punësuar rishtazi, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, përveç detyrimit për pagimin e shumës së detyrimeve tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të llogaritura nga data e konstatimit, dënohet me gjobë për çdo punonjës të padeklaruar si më poshtë:
b) tatimpaguesit e tjerë, me gjobë prej 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekësh”. Ndërsa në pikën 119 të udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, parashikohet se “...Të gjithë tatimpaguesit duhet të deklarojnë në organin tatimor përkatës të punësuarit, që fillojnë punë për herë të parë te subjekti apo të punësuar rishtazi pranë tij me të dhënat e kërkuara për secilin prej tyre. Ky deklarim duhet të bëhet të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës së të punësuarve...”.

Kolegji thekson, në interpretim edhe të dispozitave të sipërcituara, se çdo subjekt që ushtron veprimtari ekonomike dhe që punëson individë rishtazi, ka detyrimin ligjor që ti deklarojë në organet tatimore të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të detyrës. Ashtu sikurse rezulton nga kontrolli i ushtruar në datë 13.11.2013 – 14.11.2014, janë konstatuar 7 punonjës të cilën nuk janë të deklaruar në organet tatimore dhe nga vlerësimi i provave të administruara nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, konkretisht rezulton se sipas formularit E- SIG 027, këto punonjës janë deklaruar në datë 14.11.2013 dhe se do të fillojnë punë në datë 15.11.2013, pra 1 ditë mbas kontrollit të ushtruar dhe jo në ditën kur paditësi kishte detyrimin për të deklaruar punonjësit në kuptim të nenit 119 të ligjit nr. 9920/2008.

Në lidhje me sa më sipër, si me të drejtë është arsyetuar nga gjykata e shkallës së parë dhe gabimisht nga Gjykata e Apelit, Kolegji vlerëson se pala paditëse ka pasur detyrimin ligjor që të deklaronte punonjësit një ditë kalendarike përpara fillimit të punës. Pretendimi i paditësit se punonjësit kanë qenë për intervistë nuk është shkak ligjor për të pranuar padinë dhe për më tepër të arrihet në konkluzionin që organi publik ka vepruar në paligjshmëri, duke anuluar edhe aktet administrative objekt gjykimi. Kolegji vlerëson se koha e provës është rregulluar në dispozitat e Kodit të Punës dhe pavarësisht faktit që punonjësi është në kohë prove ai konsiderohet i punësuar dhe rrjedhimisht duhen respektuar të gjitha të drejtat dhe detyrimet që burojnë nga legjislacioni i punës, përfshirë edhe deklarimin në organin tatimor, të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës, sipas nenit 119 të Ligjit nr.9920/2008.

Në këto rrethana, Kolegji e gjen në interpretim të drejtë të ligjit, vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë e cila ka vlerësuar se në paligjshmëri ka qenë pala paditëse, duke mos përmbushur detyrimet ligjore të deklarimit të punonjësve dhe me të drejtë pala e paditur ka vendosur masën administrative të gjobës sipas parashikimeve të nenit 119 të ligjit nr. 9920/2008.

Kolegji thekson se Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, i ka dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, nga të cilat varej zgjidhja e kësaj çështje, ndërsa Gjykata Administrative e Apelit ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin, duke zbatuar dispozita që nuk gjejnë zbatim në rastin konkret dhe që nuk mund të merren për bazë as me analogji.

Vendimi i Gjykatës:

- Prishjen e vendimit nr. 2719, datë 21.09.2016 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 5459, datë 07.10.2014 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

6. Vendim nr.425, datë 23.05.2023, i Gjykatës Administrative të Apelit

Paditës : Shoqëria ‘‘P. M’’

I paditur: Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj Tiranë

Objekti: 1-Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të Njoftim Vlerësimit nr.____, datë 11.04.2016 dhe Raport Kontrollit me nr.____, datë 11.04.2016, për gjobat e shitjeve të mallrave nën kosto në shumën _____ lekë dhe gjobat në shumën _____ lekë.

2-Shfuqizimin e Njoftim vlerësimit nr.____, datë 11.04.2016 dhe shfuqizimin e Raport Kontrollit nr____, datë 11.04.2016 për detyrimet tatimore shtesë dhe gjobat e interesat respektive

3-Shfuqizimin pjesërisht të Vendimit te Drejtorise se Apelimit Tatimor nr.____, datë 08.08.2016

Baza Ligjore : Ligji nr.49/2012 ‘‘Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative’’, i ndryshuar; ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 ‘‘Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë’’, i ndryshuar; ligji nr.44/2015, ‘‘Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë’’; udhëzimi nr.24, datë 02.09.2008, ‘‘Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë’’, i ndryshuar etj

Përmbledhje e rrethanave të faktit

Nga kontrolli i blerjeve të shoqërisë ka rezultuar se shoqëria nuk ka deklaruar në blerje një fletë të praktikës së importit R____, datë 28.04.2014, ku është importuar mall promocional për vlerën e tatueshme _____ lekë dhe TVSH respektive _____ lekë. Kontrolli rivlerësoi blerjet e përjashtuara në prill 2014 për vlerën totale të këtij importi prej _____ lekë dhe bazuar në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ‘‘Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë’’, i ndryshuar, neni 115, shoqëria dënohet në prill 2014 me gjobë në vlerën _____ lekë (_____ lekë TVSh e importit të padeklaruar x 365 ditë x 0.06%). Gjithashtu, ka rezultuar se shoqëria nuk ka deklaruar në blerje një fletë të praktikës së importit R____, datë 14.10.2014, ku është importuar mall promocional për vlerën e tatueshme _____ lekë dhe TVSH respektive _____ lekë.

Kontrolli rivlerësoi blerjet e përjashtuara në tetor 2014 për vlerën _____ lekë dhe bazuar në Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 ‘‘Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë’’, i ndryshuar, neni 115, shoqëria dënohet në tetor 2014 me gjobë në vlerën _____ lekë (_____ lekë TVSh e importit të padeklaruar x 365 ditë x 0.06%).

Vlerësimi i Gjykatës:

Kontrolli tatimor është një ndër bazat e vlerësimit tatimor, por ky vlerësim mund të bazohet dhe në informacionin e deklaratës tatimore, siç është rasti konkret i vlerësimit të TVSH-së së kësaj periudhe. Me njoftim vlerësimin nr. _____ prot, datë 16.06.2014, DRT e Tatimpaguesve të Mëdhenj ka njoftuar tatimpaguesin për vlerësimin e kryer sipas raport kontrollit nr. _____ prot, datë 16.06.2014. Në këtë raport kontrolli, inspektori ka konstatuar se shoqëria ka shitur nën kosto dhe për këtë shkak ka

rivlerësuar (shtuar) shitjet e shoqërisë në vlerën _____ lekë.

Ne rastin konkret nuk jemi në kushtet e parashikuar në këto dispozitë ligjore për të konsideruar aktin administrativ absolutisht të pavlefshëm.

Vlerësimi sipas raportit kontrollit nr. ____ prot, datë 11.04.2016, është bazuar në vlerësimin e kryer sipas raportit kontrollit nr. _____ prot, datë 16.06.2014. Duke qënë se tatimpaguesi nuk ka reflektuar në të ardhurat e tij vlerësimin e bërë nga administrata tatimore, inspektori ka kryer vlerësimin në lidhje me tatimin mbi fitimin e vitit 2013. Kjo, pasi rritja e vlerës së tatueshme për shitjet e mësipërme, automatikisht rrit të ardhurat për periudhën tatimore përkatëse të shoqërisë, e cila ndikon në tatimin mbi fitimin vjetor, duke qënë se në të ardhurat e shoqërisë përfshihen të gjitha të ardhurat e realizuara nga shitjet e mallrave apo kryerja e shërbimeve.

Shoqëria pretendon se vlerësimi i mëparshëm, që ka shërbyer si bazë për vlerësimin aktual, është ende në procesin e ankimit gjyqësor dhe rrjedhimisht nuk duhet të kryhet vlerësim pa marrë formë të prerë vendimi i gjykatës. Pavaresisht faktit që ky vlerësim është ende në proces shqyrtimi nga Gjykata Administrative, nuk kufizon të drejtën e administratës tatimore për të kryer një vlerësim duke u bazuar në të dhënat e vlerësimit të mëparshëm. Duke qënë se si bazë për arsyetimin e raportit kontrollit nr. _____ prot, datë 11.04.2016 ka shërbyer një akt i mëparshëm i administratës tatimore (raport kontrolli nr. _____ prot, datë 16.06.2014), i cili është ende në fuqi dhe nuk është shpallur si i pavlefshëm, automatikisht çdo akt tjetër i administratës tatimore që mbështetet në të dhënat e tij, konsiderohet i vlefshëm.

Deklarimi i çmimit të shitjes me pakicë nga furnizuesi kryesor i cigareve është në zbatim të skemës së përcaktuar në Udhëzimin nr. 17, datë 13.05.2008 “Për TVSH-në”, pika 9.5.3. Por, përcaktimi i çmimit nga tatimpaguesi është në varësi të analizës çmimformuese të kryer prej tij, çka nuk përjashton shitjen kundrejt pagesës së reduktuar, sipas analizës së kryer nga administrata tatimore. Pra, fakti që tatimpaguesi deklaron çmimin e shitjes nuk nënkupton analizën e saktë të tij në lidhje me çmimin që duhet për efekte të furnizimit kundrejt pagesës, sipas përkufizimit të bërë në Ligjin nr. 7928, datë 27.04.1995 “Për TVSH-në”, nenet 18 dhe 27.

Nuk kemi të bëjmë me rikontroll sikurse pretendon pala paditese pasi siç është cituar edhe në kërkesëpadinë e kësaj të fundit, në faqen 4, ku thuhet se janë kontrolluar në vitin 2014 konkretisht i referohen raportit kontrollit nr. _____, datë 16.06.2014.

Sa më sipër bien pretendimet e palës paditese për pavlefshmëri absolute ose relative pasi nuk plotësohen asnjë nga kushtet e pavlefshmërisë.

Vendimi i Gjykatës

Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 425, datë 23.05.2023 ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë:

- Lënie në fuqi e aktit administrativ

7. Vendim Nr. 00-2023-4189, datë 25.09.2023, i Gjykatës së Lartë

Paditës : Shoqëria “E” sh.p.k, NIPT _____

Të paditur : Drejtoria e Apelit Tatimor
Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër

Objekti : konstatimi i pavlefshmërisë absolute të aktit, njoftim vlerësimi nr.____ prot datë 11.12.2014 i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër si dhe vendimi nr.____ datë 18.03.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor

Shuma e detyrimit tatimor : _____ lekë

Baza ligjore: Ligji nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimi nr.24 datë 02.09.2008 për zbatimin e këtij ligji, i ndryshuar, Ligji nr.8438 dt.28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimi nr.5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Ligji nr.7928 datë 27.04.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, Udhëzimi nr.17 datë 13.05.2008 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, Ligji nr.92/2014 datë 24.07.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, Udhëzimi nr.6 datë 30.01.2015 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, Ligji nr.9136 datë 11.09.2003 për “Për mbledhjen e Kontributeve të detyrueshme të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetsore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimi nr.23 datë 09.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore”, i ndryshuar ...

Përmbledhje e rrethanave të faktit :

Shoqëria “E” sh.p.k është subjekt tregtar në administrim të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër me NIPT _____.

Subjekti paditës më parë kishte ngritur një padi tjetër me objekt kërkimi në lidhje me aktin administrativ, njoftim vlerësimin tatimor nr.____ prot datë 11.12.2014 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër si më poshtë cituar :

“Shfuqizimin e akt kontrollit me nr.____ të datës 11.12.2014 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër të njoftuar me njoftim vlerësimin nr.____ prot datë 11.12.2014”.

Në lidhje me këtë çështje Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër doli me vendimin e saj nr.9 datë 11.01.2016, komunikuar dhe protokolluar pranë D.R.T-ve Shkodër me nr.____ prot datë 25.02.2016, me të cilin vendosi :

- *Pushimin e gjykimit të çështjes*

Nga gjykata u vendos pushimi i gjykimit të çështjes, pasi pala paditëse me kërkesë kishte hequr dorë nga gjykimi i saj.

Në vijim subjekti nëpërmjet kërkesëpadisë objekt gjykimi, nëpërmjet objektit të saj kërkon :

“konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit të njoftim vlerësimit nr.323/9 prot datë 11.12.2014 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër si dhe të vendimit nr.1409/1 datë 18.03.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor”

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër ka njoftuar Shoqërinë “E” sh.p.k me detyrime vlerësuar sipas njoftim-vlerësimit nr.____ prot datë 11.12.2014, në të cilin janë pasqyruar në mënyrë të detajuar këto detyrime sipas zërit përkatës tatimor dhe periudhave përkatëse.

Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër ka ushtruar kontroll në Shoqërinë “E” sh.p.k, duke përpiluar fillimisht Aktin e kontrollit datë 05.10.2014, bashkëngjitur tij Procesverbali nr.____ datë 29.10.2014 . Detyrat dhe kompetencat e Drejtorisë së Kontrollit Tatimor janë të përcaktuara qartë në Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr.24 datë 02.09.2008 për zbatimin e këtij ligji, si dhe në Rregulloren e Brendshme të Administratës Tatimore Qëndrore.

Kontrolli është ushtruar mbi bazën e Autorizimit për kryerje kontrolli nr.____ prot datë 01.10.2014, Njoftimi për kontroll nr.____ prot datë 01.10.2014 të nënshkruar nga vetë subjekti dhe Programi për kontroll të mirëpërcaktuar.

Sipas Program kontrollit në 1 (një) fletë subjekti do të kontrollohej për tatimin mbi vlerën e shtuar periudha 201009 – 201409 dhe Sigurime Shoqërore deri 2014/09.

Akti paraprak i kontrollit i është njoftuar subjektit me shkresën nr.____ prot datë 13.11.2014 nga organi tatimor duke iu bërë e ditur dhe e drejta e kundërshtimit të tij brenda 15 ditëve nga marrja dijani pranë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër.

Njoftimi i këtij akti është bërë nëpërmjet shërbimit postar shoqëruar me “Lajmërim marrje” Nr.____, akt në të cilin shprehet konfirmimi i subjektit paditës për marrjen në dorëzim të praktikës së këtij kontrolli.

Me aktin nr.____ prot datë 10.10.2014 nga inspektori i kontrollit është bërë një kërkesë për shtyrje të afatit të kryerjes së kontrollit, e cila është miratuar me aktin- shkresa nr.____ prot datë 10.10.2014.

Subjekti i është drejtuar me një kërkesë Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, protokolluar pranë saj me nr.____ prot datë 24.11.2014, nëpërmjet së cilës kundërshton vlerësimin sipas aktit paraprak të kontrollit.

Lidhur me këtë kërkesë të subjektit Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër është përgjigjur me shkresën nr.____ prot datë 01.12.2014, bashkëngjitur aktit përfundimtar të kontrollit duke sqaruar qëndrimin ndaj pretendimeve të tij.

Në zbatim të procedurave pas përfundimit të kontrollit subjekti është njoftuar për detyrimet e tij me Aktin përfundimtar të kontrollit me shkresën nr.____ prot datë 11.12.2014, shoqëruar së bashku me njoftim vlerësimin tatimor. Njoftimi është bërë nëpërmjet shërbimit postar shoqëruar me “Lajmërim marrje” nr.____, në të cilin shprehet konfirmimi i subjektit paditës për marrjen në dorëzim të praktikës së kontrollit përfundimtar së bashku me njoftim vlerësimin tatimor.

Në nenin 68 të Ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar **“Vlerësimi tatimor”** përcaktohet shprehimisht se:

1. Vlerësimi tatimor

a) është llogaritja e detyrimit tatimor të tatimpaguesit nga administrata tatimore...

5. *Administrata tatimore vlerëson detyrimin tatimor të tatimpaguesit, në përputhje me dispozitat e legjislacionit përkatës. Vlerësimi bazohet në :*

a) informacionin, që përmban deklarata tatimore e tatimpaguesit

b) rezultatet e një kontrolli, në përputhje me kreun X të këtij ligji

c) mënyrat alternative të vlerësimit, të parashikuara në nenin 72 të këtij ligji.

Neni 80 i ligjit nr.9920 dt.19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar “**Kontrolli tatimor**” shpreh :

1. Administrata tatimore kontrollon deklaratat tatimore, llogaritë, librat dhe regjistrimet tatimore të tatimpaguesit, përfshirë të gjithë dokumentacionin, që ka të bëjë me të ardhurat, shpenzimet, aktivet dhe pasivet dhe marrëdhëniet financiare me palë të treta.

2. Kontrolli i tatimpaguesit bazohet në deklaratat e dhëna nga tatimpaguesi, si dhe në librat, regjistrimet e informacionin e dhënë nga palët e treta ose në përputhje me mënyrat alternative të vlerësimit, parashikuar në nenin 72 të këtij ligji.

3. Administrata tatimore kontrollon saktësinë e të gjitha dokumenteve, që kanë të bëjnë me statusin ligjor, rezidencën, veprimtarinë ekonomike, pagesat dhe detyrimet tatimore, si dhe çdo dokument tjetër me rëndësi për përcaktimin e detyrimit tatimor...

Subjekti pretendonte se ka dorëzuar para organit tatimor D.R.T-ve Shkodër një “kërkesë”, “shkresë”, protokolluar pranë saj me nr.____ prot datë 29.03.2015.

Akti i tatimpaguesit protokolluar pranë D.R.T-ve Shkodër me nr.____ prot datë 29.03.2013 kishte të bënte me dorëzimin, deklarimin e Pasqyrave financiare të vitit 2012 nga ana e tij, detyrim ligjor ky dhe jo me një shkresë apo kërkesë për sistemim deklarate të T.V.SH-së.

Duke pasur parasysh se këto shitje dhe blerje janë sistemuar në Bilanc efekti i Tatim fitimit nuk preket, por përse i përket T.V.SH-së këto shitje dhe blerje nuk janë sistemuar në FDP-në e periudhës përkatëse dhe pretendimet se, subjekti ka bërë kërkesë për sistemimin e FDP-së së periudhës 2012/12 nuk janë të sakta, pasi kjo kërkesë nuk rezulton në dosjen e dokumentacionit të kësaj kompanie në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Shkodër dhe për më tepër ky numër protokollit i përket numrit të protokollit të Bilancit të vitit 2012.

Gjithashtu pavarësisht pasqyrimit në bilanc subjekti duhet të kishte bërë deklaratimet e tij mujore konform detyrimeve ligjore, në formën, mënyrën, të dhënat me vlerat e duhura dhe afatet e përcaktuara në ligj.

Subjekti duke mos qenë dakord me vlerësimin tatimor i është drejtuar Drejtorisë së Apelit Tatimor me një kërkesë ankimore në lidhje me njoftim vlerësimin.

Kjo Drejtori është përgjigjur me vendimin e saj komunikuar me shkresën nr.____ prot datë 18.03.2015 subjektit dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, nëpërmjet të cilit vendos :

Refuzimin e ankimit, pasi kërkesa për apelim nuk është paraqitur brenda afatit ligjor (30 ditë kalendarike) nga data kur njoftim vlerësimi nr.____ prot datë 11.12.2014 konsiderohet të jetë marrë nga tatimpaguesi dhe nuk është kryer pagesa e plotë e detyrimit tatimor (pa gjobat) sipas njoftim vlerësimit, lëshuar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër.

Nga subjekti nuk janë plotësuar kërkesat ligjore për marrjen në shqyrtim të kërkesës së tij ankimore, kërkesa këto të përcaktuara në Ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 106, neni 107 dhe Udhëzimit në zbatim të tij.

Vlerësimi i Gjykatës:

➤ Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, lidhur me këtë çështje doli me vendimin e saj nr.823, datë 19.12.2016, nëpërmjet të cilit vendosi :

- *Pranimin e kërkesëpadisë*
- *Konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore nr.____ prot datë 11.12.2014 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, lënë në fuqi nga vendimi i Drejtorisë së Apelit Tatimor, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë me aktin nr.____ prot datë 18.03.2015*
- *Shpenzimet gjyqësore (të vlerës së taksës së rregjistrimit të kërkesëpadisë 3000 lekë), në ngarkim të palës së paditur...*

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër në këtë vendim ka arsyetuar se :

“ Nga rrethanat e faktit në zbatueshmëri të Ligjit 9920/2008 gjykata konstaton, se me të vërtetë kontrolli pranë Shoqërisë “E” sh.p.k është me Program kontroll nr.____ prot datë 01.12.2014, lloji “Vizitë tematike”, periudhë kontrolli 09/2010- 09/2014, për T.v.sh-në dhe Sig Shoq, koha e kryerjes së kontrollit 02/10/2014-22/10/2014, por nga ana tjetër ka konstatuar se :

me datë 10.10.2014 inspektori i kontrollit ka kërkuar shtyrjen e afatit të kontrollit për 7 ditë për arsye se, nga data 13.10.2014 deri me datë 19.10.2014 është me Leje të zakonshme duke shtyrë kontrollin deri me datë 29.10.2014. Pavaresisht nga ky fakt për shtyrjen e afatit të kontrollit nga vetë inspektori rezulton që Akt kontrolli përfundimtar mban datën e hartimit 05.10.2014, ndërsa procesverbali nr.____ bashkangjitur tij mban datën 29.10.2014 në të cilin inspektori shprehet :

“Nga verifikimi i dokumenteve të vënë në dispozicion nga vetë subjekti rezultoi se, ky subjekt për disa periudha nuk ka deklaruar saktë shitje dhe blerje, pasi për periudhën 2012/12 sipas deklaramit në FDP ka deklaruar me zero shitjet ndërkohë që, ato rezultojnë _____ lekë vlerë të tatueshme, gjithashtu dhe blerjet për periudhën 2012/12 i ka deklaruar zero në një kohë, që ato rezultuan të jenë _____ lekë vlerë e tatueshme. U bë vlerësimi i këtyre blerjeve së bashku me tvsh-në përkatëse duke lindur detyrim për subjektin për tvsh-në e periudhës 2012/12, (_____ lekë x 20%) = _____ lekë si dhe konform nenit 115 “Plotësimi i pasaktë i deklaratës tatimore” subjekti është dënuar me gjobë në masën 25 % të këtij detyrimi _____ lekë.

Kjo gjykatë vlerëson se, ka një mospërputhje në kohë të konkluzioneve të inspektorit të kontrollit, i cili nga njëra ana kërkon shtyrjen e afatit të kontrollit me 7 ditë dhe nga ana tjetër harton Akt kontrollin përfundimtar me datë 05.10.2014, tre ditë pasi fillon kontrollin dhe para kërkesës për shtyrje të kontrollit, që i përket datës 10.10.2014, ndërsa data e Procesverbalit nr. ____ është datë 29.10.2014, i cili ka përshkruar gjendjen e faktit për vitin 2012/12 për T.v.Sh-në në deklaram, zero të shitjeve dhe blerjeve, duke e konsideruar shkelje të nenit 115 të Ligjit 9920/2008 e duke mos njohur kërkesat e nenit 67 të po këtij ligji si dhe veprimeve të vetë paditësit, i cili në datë 29.03.2013 ka depozituar pranë DRT Shkodër së bashku me Bilancin e vitit 2012 kërkesën për sistemimin e situatës financiare të vitit 2012 duke deklaruar vlerën e tatueshme të blerjeve dhe shitjeve veprim ky, që është bërë brenda afatit që parashikon neni 67 i Ligjit 9920/2008.

Për pasojë, nëse administrata tatimore do të kishte vepruar konform nenit 67 të ligjit “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar, paditësi nuk do të kishte patur asnjë pasojë në shtimin e detyrimeve tatimore, pasi shtesa e detyrimit që do të kishte dalë si rezultat i deklarimit me dy muaj vonesë do të ishte mbuluar nga teprica kreditore e TVSH-së që në Mars të vitit 2013, e cila ka qenë mbi _____ lekë të reja. Veprime të kundërta këto të administratës tatimore me konkluzionet e inspektorit i cili pranon, që ka një shkresë nga ana e paditësit për rregullimin e situatës financiare, gjithashtu pranon se këto shitje e blerje të muajit dhjetor janë deklaruar në Bilancin kontabël të vitit 2013 e në të njëjtën kohë vepron në mënyrë abuzive në llogaritjen e gabuar të detyrimeve.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë e konsideron aktin administrativ, njoftim vlerësimin nr. _____ prot datë 11.12.2014 të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër si dhe vendimin nr. _____ datë 18.03.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor, si akte të dala në mosrespektim të nenit 61 e 85 të Ligjit 9920/2008, i ndryshuar, absolutisht të pavlefshëm për shkak të ligjit dhe një pavlefshmëri e tillë është aq thelbësore sa e bën të cënueshëm të gjithë aktin sipas nenit 116 të K.Pr.Administrative, për pasojë gjykata vendos pranimin e kërkesëpadisë sipas objektit ...

Mbi bazën e kërkesës ankimore të palës së paditur çështja është shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Apelit, e cila vlerëson se, gjykata e shkallës së parë nuk ka bërë një cilësim të saktë të fakteve që lidhen me mosmarrëveshjen duke arritur në konkluzione jo ligjore lidhur me ekzistencën e kushteve të pavlefshmërisë absolute të akteve objekt gjykimi.

Gjykata referuar shkakut ligjor dhe objektit të padisë në lidhje me kërkimin e paditëses, Shoqëria “_____” sh.p.k, përsa i përket pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, njoftim vlerësimit nr. _____ prot datë 11.12.2014 të Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër si dhe të vendimit nr. _____ datë 18.03.2015 të Drejtorisë së Apelit Tatimor i referohet kushteve të sanksionuara në nenin 116 të Kodit të Procedurave Administrative.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se, njoftim vlerësimi nr. _____ prot datë 11.12.2014 i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër është akt administrativ i nxjerrë nga një organ administrativ i identifikuar sikurse është Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër. Ky akt administrativ është nxjerrë brenda kompetencave ligjore. Drejtoritë Rajonale Tatimore kanë kompetencë që të marrin vendime në lidhje me vlerësimin e detyrimeve tatimore sipas dispozitave të kreut VIII të Ligjit nr.9920/2008 mbi vlerësimin tatimor. Duke qenë se akti është nxjerrë nga një organ i identifikuar brenda kompetencave të tij ligjore mbetet që të analizohet, nëse vendimi objekt kundërshtimi është nxjerrë apo jo në përputhje me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji.

Gjykata Administrative e Apelit vlerëson se ndryshe nga sa ka konkluduar gjykata e shkallës së parë, në rastin konkret nuk gjendemi në kushtet e rikontrollit për të njëjtin lloj detyrimi tatimor e për të njëjtën periudhë tatimore. Kontrolli tatimor i palës paditëse rezulton se është kryer për të verifikuar llogaritjet, deklarimin dhe derdhjen e detyrimit në lidhje me TVSh-në për periudhën 2010/09 - 2014/09 dhe kontributet e sigurimeve shoqërore për periudhën 2013/06 - 2014/09. Periudha tatimore që i është nënshtruar kontrollit tatimor mbi deklarimin e subjektit për zërat tatimore të sipërcituar nuk rezulton të ketë përputhje me kontrollin e kryer sipas njoftimit të kontrollit nr. _____ datë 31.05.2012 sipas të cilit është kontrolluar zëri tatimor i Tatimit mbi të ardhurat për periudhën 01.01.2009 deri në datën 31.12.2012 si dhe Sigurimi i kontributeve shoqërore për periudhën 2010/09 - 2012/03.

Si rrjedhojë kjo gjykatë vlerëson se nuk gjendemi në kushtet e rikontrollit tatimor për të njëjtën periudhë tatimore dhe për të njëjtat lloje të detyrimit tatimor. Për rrjedhojë pala e paditur DRT

Shkodër nuk ka qenë e deyruar të marrë miratimin me shkrim të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve për këtë kontroll tatimor të kryer ndaj palës paditëse. Ky kontroll tatimor është kryer në respektim të nenit 85 të Ligjit nr.9920/2008.

Administrata tatimore mbart detyrimin që të kontrollojë saktësinë e të gjitha dokumenteve, që kanë të bëjnë me statusin ligjor, rezidencën, veprimtarinë ekonomike, pagesat dhe detyrimet tatimore si dhe çdo dokument tjetër me rëndësi për përcaktimin e detyrimit tatimor, ndërsa zgjedhja e tatimpaguesve që kontrollohen bëhet në bazë të analizës së vlerësimit të riskut sikurse DRT Shkoder ka vepruar në rastin e subjektit paditës.

Pala paditëse në lidhje me kontrollin e ushtuar është lajmëruar me shkresën nr. ____ prot të DRT-ve Shkodër në përputhje të nenit 81 të Ligjit, ndërsa në përfundim të kontrollit sipas periudhës së caktuar është mbajtur Akti përfundimtar i kontrollit, Procesverbalet përkatëse, të cilët argumentojnë shkeljet e konstatuara dhe përcaktojnë detyrime konkrete për subjektin, të cilët i janë bërë të ditura duke i komunikuar aktin përfundimtar të kontrollit me shkresën nr. ____ prot datë 11.12.2014. Pala paditëse ka paraqitur observacion dhe është dëgjuar mbi kundërshtimin e detyrimeve të konstatuara nga pala e paditur.

Kjo gjykatë vlerësoi se palës paditëse i janë vënë në dispozicion akt rivlerësimi i mbajtur në lidhje me arsyet dhe llogaritjet e detyrimeve të saj tatimore. Me të drejtë pala e paditur ka pretenduar se nuk jemi në kushtet e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore për faktin se njoftimi i paditësit është kryer për çdo fazë të kontrollit tatimor. Në kushtet kur pala paditëse ka rezultuar me diferenca tatimore të padeklaruar në dekalatat tatimore, pasqyrimi i tyre në sistemin informatik rezulton si mospagim në afat i detyrimeve tatimore. Në analizë të kushteve të pavlefshmërisë absolute të aktit që kundërshtohet ai konsiderohet i rregullt nga pikëpamja e kërkesave formale të përcaktuara në nenet 106, 108 të K.P.A-ve, pasi është hartuar në formën shkresore duke pasqyruar organin që ka nxjerrë aktin, vulën e institucionit, nënshkrimin e zyrtarit kompetent, subjektin të cilit i drejtohet, shumën e detyrimit që është vlerësuar, qëllimin e nxjerrjes së aktit, faktet në të cilat është bazuar nxjerrja e aktit të raportuara sipas zërave analitikë të raport kontrollit që i bashkëngjitet aktit dhe bazën ligjore mbi të cilin është nxjerrë akti.

Akti objekt gjykimi përmban kërkesat ligjore të përcaktuara nga neni 69 i Ligjit nr.9920/2008 “Për Procedurat Tatimore në R.Sh-së”, i ndryshuar.

Kjo gjykatë vlerëson, se pala e paditur D.R.T-ve Shkodër ka respektuar procedurën e parashikuar nga ligji në nxjerrjen e aktit administrative, njoftim vlerësimi për detyrimet tatimore për arsyet e sipërpërmendura dhe ai nuk është një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm sikurse ka arsyetuar gjykata e shkallës së parë.

Gjithashtu, Gjykata vlerëson se me të drejtë Drejtoria e Apelimit Tatimor ka vendosur refuzimin e ankimit, pasi pala paditëse nuk ka provuar që të ketë kryer pagesën e plotë të detyrimit që kundërshtohet paraprakisht apo të jetë vendosur garanci për të, sikurse parashikon paragrafi 107.3.1 e Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.24 datë 02.09.2008 “Per Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Përfundimisht gjykata vlerëson se dhe vendimi i D.A.T nr. ____ date 18.03.2015 është një vendim i dhënë nga një organ i identifikuar në përmbushje të neneve 106, 107, 108 të Ligjit nr.9920 date 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe nuk ka asnjë element të pavlefshmërisë absolute, sikundër ka pretenduar pala paditëse e si e tillë duhet të lihet në

fuqi.

Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin e saj nr.318 datë 27.04.2023, vendosi: *Ndryshimin e vendimit nr.823, datë 19.12.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër dhe rrëzimin e padisë si të pabazuar në ligj dhe në prova.*

- Mbi bazën e Rekursit të palës paditëse, Kolegji konstatoi se, në përmbajtje të rekursit nuk përcaktohet asnjë prej rasteve të germës “a”, “b” apo “c” të nenit 58 të ligjit nr.49/2012, që bën të mundur shqyrtimin e pretendimit për cënimin në thelb të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Kolegji vlerësoi të theksojë, se është detyrë e palës rekursuese të parashtrojë qartësisht dhe në mënyrë të plotë në rekurs shkaqet ligjore duke argumentuar, se përse është zbatuar në mënyrë të gabuar nga gjykata ligji material apo procedural dhe përse shkalla e shkeljes është e një rëndësie themelore për njehsimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, si dhe cilat janë ato shkelje të rënda procedurale që ndikojnë dukshëm në dhënien e vendimit. Nëse shkaqet ligjore nuk arrihen të parashtrohen dhe të argumentohen sipas kërkesave që ka neni 58 i ligjit nr 49/2012, atëherë Gjykata e Lartë është e detyruar të vendos mospranimin e rekursit.

Vendimi i gjykatës :

Gjykata e Lartë me vendimin e saj Nr. 00-2023-4189 datë 25.09.2023 ka vendosur :

- *Mospranimin e rekursit të palës paditëse “E” sh.p.k, kundër vendimit nr.318 datë 27.04.2023 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë*